

5 Janar 2025

I nderuar Kryeministër Kurti,

Ju përcjell urimet e mia të sinqerta juve dhe Lëvizjes Vetëvendosje për fitoren në zgjedhjet parlamentare të 28 dhjetorit. Procesi zgjedhor ishte i lirë, i ndershëm dhe demokratik, duke dëshmuar pjekurinë institucionale të Republikës së Kosovës dhe përkushtimin e qytetarëve ndaj demokracisë.

E ndoqa me vëmendje fjalimin tuaj pas mbylljes së votimeve dhe e vlerësova veçanërisht gjuhën e matur, përfshirëse dhe thirrjen për unitet politik. Mesazhi që dhatë është i rëndësishëm në këtë fazë që po kalon Kosova. Tani është në interes kombëtar krijimi i shpejtë i institucioneve funksionale.

Qasja e Presidentit amerikan Donald Trump “Paqe përmes Forcës” dhe Ligji për Autorizimin e Mbrojtjes Kombëtare, i cili hyri në fuqi pak ditë më parë, krijojnë një mundësi reale për përparim. Me institucione të forta në Prishtinë dhe koordinim të ngushtë me Uashingtonin, Kosova ka një shans historik për të mbyllur çështjet e hapura dhe për të ecur përpara drejt integritetit euroatlantik, përfshirë anëtarësimin në NATO, një aspiratë e jona që do të garantonte sigurinë e shqiptarëve në Ballkan.

Tani është thelbësore që Kosova të ketë disiplinë, të përmbushë detyrimet e saj dhe të shmangë deklaratat apo veprimet që krijojnë keqkuptime me aleatët.

Ju mund të llogarisni në ndihmën time për të forcuar lidhjet me Shtëpinë e Bardhë, Departamentin e Shtetit dhe Kongresin amerikan, marrëdhënie që i kam ndërtuar për më shumë se 30 vite angazhim për Kosovën.

Ju uroj suksese në këtë mandat të rëndësishëm dhe besoj se në katër vitet e ardhshme Kosova do të vazhdojë rrugën e saj përpara si partner i besueshëm i SHBA-së, sepse vetëm kështu demokracia do të zhvillohet, vendi ynë do të jetë më i fortë ekonomikisht dhe më i sigurt.

Zoti ju bekoftë ju, Kosovën dhe gjithë popullin shqiptar.

Me respekt,

A blue ink signature, appearing to be 'H. Bajraktari', is written over the text 'Me respekt,' and above the name 'Harry Bajraktari'.

Harry Bajraktari